VENDIM
Nr. 346, datë 12.6.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 832, DATË 3.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 832, datë 3.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pjesën hyrëse të vendimit të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi parë i pikës 2 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Dokumentacioni i privatizimit i përgatitur nga ekspertët vlerësues përmban: ... ";

b) Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 e 2.2, me këtë përmbajtje:

"2.1. Dokumentacioni i privatizimit, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të përcaktuar në urdhrin e ministrit, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, i dërgohet Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës, të krijuar me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë, për verifikimin, konfirmimin dhe transparencën e procedurave të vlerësimit dhe hartimit të dokumentacionit për paketat shtetërore të aksioneve që dërgohen për shitje/privatizim;

2.2. Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës i rekomandon ministrit përgjegjës për ekonominë vijimin e procedurës së privatizimit nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nëse ekziston dokumentacioni i kërkuar ligjor dhe ka kaluar në të gjitha strukturat e parashikuara në këtë vendim.

Në rast të kundërt, Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës kërkon plotësimin e dokumentacionit.".

2. Në kreun I bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, të shkronjës "A", fjalët "… në dy gazeta me qarkullim kombëtar, nga një botim në secilën gazetë ..." zëvendësohen me "… në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare ...", ndërsa shprehja "… në televizion dhe …" hiqet.

b) Në pikën 1, të shkronjës "C", në vazhdim të fjalëve "… në mbështetje të…" shtohet "… ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", …".

3. Kudo në vendim, emërtimi "Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave" zëvendësohet me "Agjencia e Trajtimit të Pronës", emërtimi "Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike" zëvendësohet me fjalët "... struktura përgjegjëse për shitjen e pronës ...", ndërsa fjalët "... ministria përgjegjëse për ekonominë ..." dhe emërtimi "Ministria e Financave" zëvendësohen me emërtimin "Ministria e Financave dhe Ekonomisë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama